

“Me mijëra migrantë nga Lindja e Mesme dhe Afrika, kanë përfunduar në fund të Mesdheut, ku së bashku me ta, është duke u kalbur edhe humanizmi i një pjese të madhe të gjinisë së sotme njerëzore e ku bëjnë pjesë edhe shqiptarët, që pyesin se ç’kërkojnë këta myslimanë në Evropën e tyre të civilizuar dhe humane!? Pra ku kalbet humanizmi i atyre që më parë anëtarësohen në organizatat për mbrojtjen e qenve, maceve..., se sa ta ndihmojnë një fëmije të lindur nga prind, që nuk i takojnë etnisë, fesë apo ngjyrës së tyre! Mediat e sotme kanë botuar foton rrëqethëse të një fëmije sirian – Engjëll – dyvjeçarë, që e ka nxjerrë uji të mbytur në një plazh të Bodrumit të Turqisë, mbase sepse edhe fundi i detit nuk ka pranuar të bëhet varr i atij trupi të pafajshëm! Ajo foto tregon fytyrën e kohës në të cilën jetojmë, por atë foto nuk kam aq forcë ta publikojë këtu! Në vend të saj, po ua përcjell një foto ku shihen njerëzit e trishtuar për fatin e delfinëve që janë duke i shpëtuar! U mundova, po nuk gjeta asnjë foto ku do i shihje evropianët e dalë në brigjet e Mesdheut, të gatshëm t’i shpëtojnë e t’i presin ata që i ka tradhtuar atdheu i tyre!” (Kim Mehmeti)

//

“Me mijëra migrantë nga Lindja e Mesme dhe Afrika, kanë përfunduar në fund të Mesdheut, ku së bashku me ta, është duke u...

Posted by [Kim Mehmeti](#) on [Wednesday, September 2, 2015](#)